

URDHËR
Nr. 305, datë 30.5.2019

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR PRIVAT, GJIMNAZI “UNIVERS NETWORK”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikave 3 dhe 7, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të udhëzimit nr. 15, datë 12.7.2013 “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi “Univers Network”, Tiranë, në përfundim të vitit shkollor 2018–2019.

2. Institucioni arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi “Univers Network” ka këto detyrime:

a) të pajisë çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar;

b) të vërë në dispozicion të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër;

c) të kthejë pagesat e kryera nga nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbytur që mund të ketë ndaj nxënësit;

d) të dorëzojë në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer;

e) të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij urdhri, të mbulohen nga institucioni përkatës i arsimit parauniversitar privat.

3. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit ndodhet shkolla, ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune dhe, brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi “Univers Network”;

b) të marrë masat për transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të gjithë nxënësit e regjistruar në këtë institucion arsimor;

c) të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar privat;

d) të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit për arkivat, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi “Univers Network”.

4. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të marrë të gjitha masat sipas parashikimeve të Kodit Civil, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi për personin juridik që përfaqëson institucionin e përcaktuar në pikën 1, i cili nuk zbaton këtë urdhër.

5. Urdhri nr. 26, datë 25.1.2016 i ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar, shkollë e mesme e përgjithshme e profilizuar “Univers Network”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtorja e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në MASR, Institucioni

arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe institucioni arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi “Univers Network”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Besa Shahini